

Mirë se vini në shkollë

Më shumë të dhëna mund të merrni prej drejtorit dhe mësuesëve të shkollës.



Përmbajtja

1. Mësimi i obliguar
 - shema e sistemit shkollor të Finlandës
 - Mësimi pa pagesë
 - Ushqimi pa pagesë
 - Përgjegjësia e kujdestarit
 - Përgjegjësia e nxënësit
2. Viti shkollor
 - Testet
 - Orari
 - Dita e shkollës
3. Lëndët mësimore
 - Finlandishtja gjuhë e dytë
4. Mësimi plotësues
5. Mësimi i veçantë
6. Rregullat e shkollës
7. Vlerësimi
8. Punëtorët e shkollës
9. Përkujdesja shëndetsore në shkollë
10. Nxënësi i gjuhës së huaj në shkollë.


1. Shkollimi i obliguar

Në Finlandë gjithë fëmijët 7 vjeçar janë të obliguar të vijnë në shkollimin. Shkollimi i obliguar kanë edhe fëmijët dhe të rinjtë e huaj që jetojnë në Finlandë.

Mësimi fillor është 9 vjetë dhe është i obliguar. Pas kësaj nxënësit mund të plotësojnë mësimet në klasën shtesë apo të 10-të. Pas kryerjes së shkollës fillore, nxënësit mund të vazhdojnë shkollimin në gjimnaz apo shkollë profesionale.

Sistemi i shkollimit

Tregu i shkollimit





Shkollimi pa pagesë

Mësimi dhe librat e mësimi janë pa pagesë në shkollën fillore.

Ushqimi pa pagesë

Nxënësve u ipet një shujtë ushqim pa pagesë në shkollë. Për zgjedhje të veçantë të ushqimit është mirë të lajmërohet që me fillimin e shkollës.



Përgjegjësia e kujdestarit

Përgjegjësia e kujdestarit është që obligimi i shkollimit të nxënësit të mbahet.

Kujdestari duhet të lajmëroj kur nxënësi mungon. Për mungesë nxënësit i duhet leje.

Përgjegjësia e nxënësit

Nxënësi merr pjesë në mësim, i kryen detyrat dhe silllet mirë.

2. Viti shkollor

Viti shkollor është në kohën prej 1.8 - 31.7. Ndahet në pjesën vjeshtore dhe pjesën verore.

Pjesa vjeshtore fillon në gusht dhe mbaron në pushimet e dhjetorit. Pjesa pranverore fillon në janar dhe mbaron në pushimet e qershorit.

Gjatë vitit shkollor ka edhe pushime tjera të shkurtëra.

Festat e shkollës

Në shkollë mbahen festa të ndryshme të kulturës finlandeze.

Orari

Orari është pjesë e ditës shkollore të nxënësit. Në orar shifën lëndët që i mëson nxënësi. Ndryshime në orar ndodhin nganjëherë. Raste të ndryshme janë p.sh. shetijet, festat, manifestimet sportive apo vijimet e mësimëve. Edhe këto janë pjesë e rëndësishme e vijimit të shkollës.

Përmbajtja e ditës së shkollës


- orët e mësimit
- pushimi në mes të orëve kur nxënësit dalin jashtë në oborr.
- detyrat që duhet të kryhen në shtëpi.
- mënyrat e ndryshme të mësimit.

3. Lëndët mësimore

Gjuhë amtare dhe letërsi (finlandishtë), gjuhët e huaja, matematika, biologjia, gjeografia, dituria e natyrës, detyrat qytetare dhe njohuri shoqërore, histori, kimi, fizikë, fe apo mësimi për jetë.

Art- dhe shkathtësitë: vizatim, punë dore, edukatë fizike, muzikë.

Arti dhe shkathtësitë nuk janë mësim fetar. Ed. fizike është pjesë shëndetsore. Në ed. fizike nxënësit duhet të kenë rroba të përshtatshme.



Finlandishtja si gjuhë e dytë

Nxënësve të gjuhës së huaj mësimi i gjuhës finlandeze ka për qëllim që tu ndihmoj në mësimin të kuptojnë gjërat themelore që të mund të veprojnë e mësojnë në grupin e gjuhës finlandeze.

4. Mësimi plotësues

Mësimi plotësues u ipet nxënësve që kanë nevojë për mësim shtesë

5. Mësimi i veçantë

Nxënësve u ipet mësim i veçantë kur për mësim të nxënësit është i domosdoshëm.

6. Rregullat e shkollës

Në shkollë ka rregullore të cilës duhet përmbajtur.

D.m.th. ku u sigurohet të gjithëve ambient i mirë mësimi.

Me thyerjen e rregullave nxënësi mund të denohet.

- me largimim e nxënësit nga klasa

- në bisedë te drejtori

- duke e lënë mbas mësimin në shkollë ku edhe lajmërohet kujdestari i nxënësit.

7. Vlerësimi

Nxënësve dhe kujdestarëve të tyre u ipen të dhëna për vijimin e mësimin me nota apo vlerësim në fjalë. Në fillim të mësimin vlerësohen me fjalë. Më vonë në diplomë bëhet vlerësimi me numra. Numrat përdoren pre 4 - 10-të. Nota 5 do të thotë notë e dobët dhe nota 10 dituri dhe shkathtësi të shkëlqyera.

Nxënësi i huaj që jeton në Finlandë e merr diplomën e shkollës fillore atëherë kur i kryen të gjitha mësimet e shkollës fillore.

8. Punëtorët e shkollës

Në shkollë punojnë punëtorë të gjinisë femrore dhe mashkullore.

- shkollën e drejton drejtori apo udhëheqsi i shkollës.

- mësimin e japin musuesit klasor prej klasës 1 - 6-të.


- mësimin japin edhe mësuesit e veçantë.

- këshilltarët për mësim ju ndihmojnë nxënësve në mësim të mëtutjeshëm.

Gjithashtu në shkollë punojnë të rritur që nuk marrin pjesë në pjesën mësimore si pedagogu, sekretari, pastruesi, shtëpijaku, punëtorët e kuzhinës, motra medicinale.

9. Shërbimi shëndetsor në shkollë

Qëshija e shëndetit të nxënësit dhe familjes së tij janë në përkujdes dhe besim. Prej kujdestarës së nxënësit kërkohet të marr pjesë në kontrollën mjeksore të nxënësit. Me kontrollë vlerësohet gjendja shëndetsore e nxënësit.



10. Nxënësi i gjuhës së huaj në shkollë

Mësuesja ka nevojë për informata për mësimin e mëparshëm. P.sh. për vështrirësitë në gjuhë që është me rëndësi të bisedohet që nxënësit ti afrohet ndihma e duhur. Kujdestarja është mirë të njoftohet me mësuesen. Në takim me mësuesen është e mundshme ta marr përkthyesin. Nxënësit kanë fletoren për njoftimet të ditëve të punës, ku mësuesja dhe kujdestarja mund të shenojnë të dhënat e rëndësishme që i përkasin nxënësit.